

MISIONI YNË

Të ndihmojë klientët të arrijnë sukses jetëgjatë duke u ofruar shërbime rehabilitimi të gjithanshme, profesionale dhe me dhembshuri.



*e besueshme, me dhembshuri
dhe e bashkëpunueshme*

Informacion kontakti

Për më tepër të dhëna rreth shërbimeve tona, ju lutemi të kontaktoni Drejtorin tone,

Jeff Tronetti

Tel.: 905.633.9000

Faks: 905.633.9001

info@genesiscr.com

www.genesiscommunityrehab.com

*Ofron shërbime mbështetëse
në gjithë Ontarion jugqëndrore
tek personat me trauma në kokë
dhe probleme të shëndetit mendor*

VIZIONI YNË

Të njihemi si ofruesi kryesor i shërbimeve krijuese, te efektshme dhe përparimtare tek individët të cilët janë duke jetuar pasojat e një dëmtimi në kokë dhe/ose janë diagnozuar me problem(e) të shëndetit mendor.

Me fokus tek klienti: E vlerësojmë klientin dhe pjesëtarët e familjes së tij si pjesë të pandarë të ekipit mjekësor, duke ruajtur nivelin më të lartë të dinjitetit dhe respektit. Ofrojmë program individual që i përshtatet nevojave të veçanta të çdo klienti.

Bashkëpunues: Ofrojmë një seri të plotë njoftimesh më të fundit nëpërmjet shënimeve dhe raporteve objektive dhe të detajuara tek pjesëtarët e ekipit të rehabilitimit. Kjo gjë ruan një model transparent dhe të lirshëm komunikimi.

Përparimtarë: Përdorim strategji dhe teknika kompensuese për të përmirësuar objektivat e programit nën drejtimin e mbikqyrjen e një profesionalisti/e mjekësore të licensuar.

SHËRBIMET TONA

Qëllimi ynë kryesor është të ndihmojmë çdo klient të arrijë nivelin optimal të pavarësisë. Nën drejtimin e një profesionalisti/e mjekësore të licensuar, Qendra Komunitare e Rehabilitimit Genesis ofron një gamë të gjërë shërbimesh duke përfshirë:

Shërimin e ngadaltë

- Rrit nivelet e reagimit dhe ndjeshmërisë
- Rrit ndërgjegjshmerinë ndaj ambientit përreth

Kontrollin e sjelljes

- Kontrolli i inatit dhe stresit
- Promovimi i sjelljeve që i përshtaten ambienteve të shumëllojshme.
- Kontrolli i sjelljeve neurologjike dhe impulsive.

Përmirësimin e komunikimit

- Ushtrime komunikuese me karakter njohës dhe zbatimi i strategjive në kontekst të komunikimit.

Përmirësimin kognitiv

- Strategji kompensuese për kujtesën, organizimin dhe marrjen e vendimeve, planifikimin, nisjen, ndjekjen dhe përfundimin.

Ritrajnimit e aftësive

Kujdesi për veten, produktiviteti, koha e lire, punët e përditshme, punët e mirëmbajtjes së shtëpisë dhe psonisjet.

Drejtimin financiar

Buxheti dhe banka

Mbështetjen arsimore dhe profesionale

- Ndihma dhe mbështetja për të gjetur punë Ofrimi i rekomandimeve për modifikime dhe përshtatje të duhura të programit shkollor

Edukimin ABI dhe të shëndetit mendor

- Udhëzime praktike, mbështetje dhe pjesëmarrje në grupet dhe resurcet komunitare të mbështetjes.

Trajnimi fizik personal

- Programe ushtrimesh personale
- Përmirësimi i gjithanshën i shëndetit dhe gjendjes fizike
- Përmirësimi i games së lëvizjeve, forcës, lëvizshmërisë dhe rezistencës ndaj aktiviteteve.

Ri-integrimi në komunitet

- Ri-integrimi tek, ose prezantimi me sportet, aktivitetet dhe programet shoqërore.

PERSONELI YNË

Nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm profesional, ekipi i Qendrës Komunitare të Rehabilitimit Genesis aplikon zgjidhje të efektshme rehabilitimi për të plotësuar nevojat e sotme dhe të ardhshme të klientit. Punonjësit tanë të rehabilitimit ofrojnë kujdes individual nën mbikqyrjen e drejtpërdrejtë të një profesionalisti/e mjekësore të licensuar.

- Me njohuri të plota
- Me aftësi të veçanta
- Që nuk ia prishin qejfin klientëve

Ekipi drejtues është mëse i gatshëm të ofrojë konsultime për të siguruar një shërbim cilësor pa kosto të lartë.